KRONIKË E ZEZË

Sekuestrohen dy armë që dyshohet se u përdorën në aheng familjar

23 korrik 2023, 18:57

Shpërndaje në

Policia e Kosovës njoftoi se i ka sekuestruar dy armë zjarri mbrëmjen e së shtunës, që dyshohet se janë përdorur në një aheng familjar.

Autoritetet u kanë bërë thirrje qytetarëve që t'iu shmangen veprimeve të tilla, për shkak të sigurisë dhe me qëllim që "ceremonitë festive t'i kalojnë pa ndonjë incident".

Policia shtoi se në raste të tilla, obligohet të fillojë kërkimin e armëve, të ndalojë kolona të dasmorëve për t'i kontrolluar dhe të ndërmarrë bastisje nëpër shtëpi ku dyshohet se ka armë.

"Nisur nga fakti se akoma është prezent si dukuri, përdorimi i armëve të zjarrit në ndeja dhe ahengje të ndryshme, strukturat operative rajonale të policisë po vazhdojnë punën për parandalimin e kësaj dukurie. Policia e Rajonit të Prishtinës, konform detyrimit ligjor që ka, obligohet që në rastet e tilla të filloj kërkimin për armët e përdorura në rast, të ndaloj kolonat e dasmorëve për t'i kontrolluar ato dhe personat e dyshuar dhe në situata të caktuara të ndërmarrë edhe bastisje në shtëpitë ku dyshohet për raste të tilla. Një nga këto kontrolle është realizuar mbrëmë nga zyrtarët e stacionit policor veriu në Prishtinë, të cilët kanë sekuestruar 2 armë zjarri të cilat dyshohet të jenë përdorë në aheng familjar", thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#SEKUESTRIM #GJUAJTJE NE AHENG FAMILJAR #KRONIKE

Digjet një autobus në rrugën Prishtinë-Podujevë

Dy kamionë e një furgon përfshihen nga zjarri në Mitrovicë

U lëndua duke punuar në pyll, kaçanikasi në gjendje të rëndë

Në Skenderaj, 21-vjeçari dyshohet se gjuajti me armë në aheng familjar

Një i burgosur vdiq në QKUK

Gjendet një trup i pajetë në lumin Drin

Aksident në Ulpianë, taksi përplas shtyllën

TabQla Feed

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored

Lexo më shumë

Adults on Medicare Get a Huge Surprise This Month

Sponsored Listings | Sponsored

Mustafa: Kurti s'ka pasur nevojë ta tensionojë situatën, dëshiron të marrë poenë për shtensionim

Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa ka akuzuar kryeministrin Albin Kurti për tensionim të situatës në vend. Ai ka deklaruar se Kurti po krijon reagim ndërkombëtar dhe sipas tij, po …

Kohanet

Online Programming Courses Might Surprise

Sponsored Listings | Sponsored

Booking Family Visits for The Holidays? See Hotel Prices

Hotel Prices | Search ads | Sponsored

Luxury Villas In Dubai: Prices May Surprise You!

Dubai Real Estate | Sponsored

Digjet një autobus në fshatin Besi të Prishtinës

Një autobus është përfshirë nga zjarri në fshatin Besi të Prishtinës. KOHA ka siguruar pamje të autobusit që po digjej, ndërsa është në pritje të informacioneve zyrtare nga Policia.

Kohanet

Tirana Residents Turning To Turkey For Dental Implants (Know Why?)

Dental Implants | Search Ads | Sponsored

TË TJERA

Shoferi bëhet nervoz për gjobën, kapet me policët

Vdiq një person, u rrokullis me traktor

Polici e gjobit, i dyshuari ia publikon foton në Facebook me përshkrim urrejtës

Një zjarrfikës kërkon ndihmë mjekësore pas zjarrit në supermarketin në Klinë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!